

Dr. Genciana Abazi - EGRO

DERVISH SALI ASHKIU DHE KOPJA E TIJ E DIVANIT SHQIP TË NEZIM BERATIT

- Përpyetje për lëvrimin e gjuhës shqipe në gjysmën e parë të shekullit XIX -

Fillesat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIX deri më sot, janë vlerësuar si një “revolucion i brendshëm, i qetë shpirtëror”.¹ Duke patur një natyrë të tillë është e vështirë që këtë periudhë historike ta analizosh duke u fokusuar vetëm në historinë politike të kohës dhe në veprimtarinë e personaliteteve kryesore të saj. Këtë vështirësi e cila haset gjatë studimit të të gjitha lëvizjeve nacionale, historiografia moderne është përpjekur ta kapërcejë me studimin e historisë së kulturës dhe historisë sociale të kohës.² Në këtë kuadër, krahas njohjes së eksperiencave dhe traditave kulturore, një rëndësi e veçantë i kushtohet dhe trajtimit të fakteve dhe ngjarjeve marginale, të cilat për arsye nga më të ndryshme nuk janë përfshirë në faqet ‘e arta’ të historisë. Studimi i këtyre fakteve sjell ndriçimin e aspekteve të cilat nuk mund të studiohen me rrugë empirike dhe ndihmon në formëzimin e kuadrit të plotë historik dhe kulturor.

Gjatë punës për përgatitjen e edicionit tekstual kritik të *Divanit* shqip të Nezim Beratit (Frakulla) më tërhoqi vëmendjen një fakt interesant. Në një kopje të Divanit shqip, të kopjuar në vitin 1847 në qytetin e Tepelenës, disa fjalë turqisht të përdorur nga Nezimi janë zëvendësuar me fjalë shqipe. Autori i kësaj kopjeje është Dervish Sali Ashkiu.

Kopja e Dervish Saliut ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit, në fondin personal të Nezim Frakullës, në dosjen 1 dhe 2. Ajo ka gjithsej 35 fletë në përmasat 11.5 x 23.5 cm. Në dosjen nr. 1 ndodhen

tridhjetë e një fletë, ndërsa në dosjen nr. 2 katër fletë të shkëputura të këtij manuskripti. Fletët janë të palidhura, kanë ngjyrë të bardhë dhe nuk kanë numërim. Rendi i faqeve ruhet në bazë të shënimit në çdo faqe të fjalës në fillim të fletës pasardhëse.

Kjo është kopja më e rregullt që ka mbërritur nga Divani shqip i Nezim Beratit. Në faqen e parë jepet titulli i veprës *Divani manzumei Nezim İbrahim Beg Rahmet-ullahi Aleyh* (Divan në vargje i Nezim Ibrahim beut. Mëshira e Zotit qoftë mbi të!) dhe mbaron me poezinë akrostike, inicuar sipas rendit të alfabetit arab. Ndërsa në margjinë të faqes 34b jepet emri i kopjuesit, Dervish Sali Ashkiu, viti i kopjimit, 1263 hixhri (1846/1847) dhe vendi i kopjimit, qyteti i Tepelenës.

Pas dervish Sali Ashkiut, kjo kopje ka qenë në pronësi të të paktën dy personave të cilët në mënyra të ndryshme kanë lënë gjurmët e tyre. I pari mendohet të ketë qenë një person i quajtur Abdurrahman. Vula e tij është përdorur në faqet e para të manuskriptit dhe më pas shumë rrallë, pranë titujve të poezive. Përveç kësaj dëshmie, për këtë person nuk kemi asnjë të dhënë tjetër. Por ajo që dihet me siguri është që përdorimi i vulave personale në kohën e Perandorisë Osmane ka qenë një dukuri shumë e përhapur. Këto vula kishin një madhësi më të vogël se vulat e korrespondencës zyrtare dhe përdorshin në vend të firmës për të dëshmuar vërtetësinë e dokumentit.³ Prandaj ka shumë gjasë që personi i quajtur *Abdurrahman* e ka përdorur këtë vulë për të treguar pronësinë e tij mbi këtë kopje. Megjithatë duhet vënë në dukje që përveç përdorimit të vulës ai nuk ka bërë asnjë ndërhyrje tjetër në manuskript.

Personi i dytë, për të cilin kemi të dhëna që ka patur në zotërim këtë manuskript është Abdullah Ferhati. I njohur për pasionin e tij në mbledhjen e dokumenteve dhe dorëshkrimeve të vjetra të shkruara me alfabetin arab, Ferhati është i pari që në vitin 1938, materialin e kësaj kopjeje e bëri publik për opinionin brenda vendit, në faqet e revistës *Zani i Naltë*.⁴ Abdullah Ferhati kopjen e dervish Sali Ashkiut e ka dorëzuar në Arkivin Qendror të Shtetit, në vitin 1952.⁵

Në historikun e kësaj kopjeje edhe Sami Frashëri ka një vend të veçantë. Në sprovën e tij për një botim në mënyrë të përmbledhur

të *Divanit* shqip të Nezimit, që mban datën Stamboll 4 qershor 1882, Sami Frashëri nën titullin *Mbledhje këngëve shqip të vjetëra dhe të ra*,⁶ ka dhënë 25 poezi (825 vargje) nga ky poet. Nga një analizë tekstuale e këtij dorëshkrimi vërtetohet se poezitë e Nezimit janë dhënë duke u mbështetur në materialin e ofruar nga kopja e dervish Sali Ashkiut.⁷ Kjo na shtyn të mendojmë që Sami Frashëri gjatë punës për transkriptimin dhe editimin e poezive të Nezimit ka patur përpara ose këtë kopje, ose një ‘kopje-bijë’ të saj.

Por kush ka qenë Dervish Sali Ashkiu? Deri më tani nuk kemi asnjë të dhënë tjetër përveç atyre që mund të nxjerrim nga kopja e *Divanit* shqip të Nezimit, të cilin ai ka kopjuar.

Nga shënimi në margjinë, në faqen 34b, mësojmë se në vitin 1847 ka jetuar në qytetin e Tepelenës. Nga vetë emri me të cilin ka nënshkruar kopjen, Dervish Sali Ashki, kuptojmë se ka qenë dervish, por përveç emrit të qytetit ku ndodhet, Tepelenë, nuk jep asnjë sqarim lidhur me teqenë në të cilën bënte pjesë.

Dervish Saliu e mbiquan veten Ashki. Nuk e dimë ekzakhtësisht nëse Ashki është mbiemër i familjes së tij, një pseudonim letrar apo një cilësim që ai ia atribuon vetes. Në turqisht *ashki* (< tur. aşkı) do të thotë “që i përket dashurisë” dhe ka një përdorim sinonimik me fjalën *ashiki* (< tur. aşığı). Të dyja këto fjalë, rrjedhin drejtpërdrejt respektivisht e para nga fjala *ashk* (< tur. aşk) që do të thotë “dashuri”, kurse e dyta nga *ashik* (< tur. aşık) me kuptimin “dashnor”. Në turqishten osmane më shumë se me kuptimin e parë ato janë përdorur me një kuptim mistik. Kjo lidhet me besimin se Zotit mund t’i afroresh vetëm me anë të dashurisë, ngaqë edhe vetë Zoti zanafillën e botës e ka filluar me dashuri.⁸ Në këtë kontekst edhe termi *ashik* përdoret për të emërtuar poetët mistikë, të cilët recitonin poezitë e tyre në ambiente publike. Repertori i tyre përmbante si këngë të natyrës fetare mistike, ashtu edhe këngë për dashurinë, elegji dhe poema të ndryshme epike.⁹ Qysh në shekullin XIV dhe më pas në shekullin XV, në historiografinë e vjetër turke haset një familje, pjesëtarët e së cilës njihen me emrin Ashiki.¹⁰ Këtë mbiemër ata e kanë marrë nga pseudonimi letrar i të parit të tyre Ashik Pasha, i përmendur si për talentin poetik ashtu edhe për afërsinë që kishte me urdhrat fetare. Kurse më i fundmi personalitet i njohur i kësaj familjeje, Ashik Pashazade, autori i historisë më të plotë të Perandorisë Osmane shkruar deri

në fund të shekullit XV, ka patur emrin Dervish Ahmet Ashiki.

Dervish Sali Ashkiu i ka njohur shumë mirë tri gjuhët e mëdha të Orientit, arabishten, persishten dhe turqishten. Shënimin në margjinë për vendin, datën dhe kopjuesin i ka dhënë në gjuhën arabe. Përveç kësaj në kopjen e tij gjejmë të përfshirë edhe një poezi persisht (f. 1a) dhe një gazel turqisht (f. 33a), të shkëputura nga Divanet turqisht dhe persisht të Nezimit.¹¹ Përfshirja e poezive turqisht dhe persisht në strukturat e Divanit shqip është një dukuri që haset vetëm në këtë kopje dhe ka të bëjë drejtpërsëdrejti me identitetin e kopjuesit dhe rolin që ka marrë ai përsipër të kryejë gjatë punë së tij.

Dervish Saliu këto dy poezi 'të huazuara' i ka pozicionuar shumë saktë në strukturat e Divanit shqip. Gazelin turqisht mbi dashurinë e ka renditur menjëherë pas dy gazeleve në shqip që bëjnë fjalë për të njëjtën tematikë. Kurse poezinë persisht kushtuar Perëndisë e ka vendosur në pozicionin hyrës të Divanit shqip, pozicion të cilin ka dhe në Divanin persisht. Kjo ka ndodhur ngaqë në Divanin shqip (në kopjen e Dervish Saliut dhe në kopjet e tjera që kanë mbërritur deri në ditët tona) mungon një poezi mirëfilli e kësaj natyre. Divani shqip hapet me poezinë *Bismilah nisa Divanë*, të cilën dervish Saliu e ka dhënë menjëherë pas poezisë persisht. Hapja e divanit me poezi persisht, ndonëse vepra është e shkruar në një gjuhë tjetër, është një dukuri e njohur kryesisht për letërsinë turke të divaneve.¹² Njohja e mirë e kësaj praktike nga dervish Sali Ashkiu ka bërë që kryerja e këtyre modifikimeve në Divanin shqip të Nezimit të bëhet në harmoni me strukturën e veprës, pa cënuar logjikën e brendshme të saj.

Ndërhyrje të kësaj natyre në vepër të shtyjnë të mendosh se Dervish Sali Ashkiu nuk ka qenë një kopjues i thjeshtë, por ka marrë përsipër edhe rolin e një editori i cili

përgatit veprën për një audiencë të caktuar lexuesish. Këtë mendim e përforcon edhe fakti se gjatë kopjimit janë bërë disa ndërhyrje redaktoriale që kanë të bëjnë kryesisht me zëvendësimin e disa turqizmeve me fjalë shqip, apo me turqizma të tjerë që janë më të përdorshme në shqipe.

Nga një krahasim me kopjet e tjera të *Divanit* shqip të Nezimit, që kanë mbërritur deri në ditët tona, vërehet se dervish Sali Ashkiu fjalën turke *laqin* e ka zëvendësuar me fjalën shqipe *veç, rengje*

veshënë me stoli veshënë, ejllëk me gjellëra, nazme me çdo fjalë dhe shprehjen zura figanë me mentë na vanë. Kurse për turqizmat lika dhe rakib ka përdorur korrespondueset e tyre respektivisht surrat dhe hasetçi. Dervish Saliu ka bërë dhe disa modifikime të kufizuara në numër që sjellin një modernizim të gjuhës së Nezimit, si p.sh. tat dhe tate e ka zëvendësuar me tënd dhe tënde, ap me jap, lipën me jepi, ndë me në, gjer nashti me këtu tutje.

Dervish Saliu në kopjen tij shqipen e ka shkruar me alfabetin arab. Ai është treguar i kujdesshëm në përdorimin e shenjave diakritike për të treguar vendin dhe mënyrën e leximit të zanoreve duke lehtësuar kështu punën për vokalizimin e fjalëve. Krahas kësaj, për bashkëtingëlloret *gj* dhe *nj* ai ka përdorur në mënyrë sistematike shenja të veçanta grafike ج dhe ن . Këto dy bashkëtingëllore në kopjet e tjera, për shkak të neglizhencës dhe kopjimi të nxituar jepen me *kef* (ك), me të njëjtën grafemë që i identifikohet edhe germa *q*.

Nga ndërhyrjet që ka bërë dhe nga mënyra se si i ka realizuar këto ndërhyrje, me shkallën e njohjes së derisotshme mund të themi se dervish Sali Ashkiu është i pari në historinë e letrave shqipe që ka filluar punën për editimin e letërsisë shqipe me alfabetin arab. Këtë punë pas 35 vjetësh do ta rimernte në dorë Sami Frashëri, i cili gjatë procesit të editimit transkripton edhe pjesë të Divanit shqip në alfabetin e Stambollit. Kurse vepra e parë e plotë e letërsisë së bejtexhinjve që do të shihte dritën e botimit është *Erveheja* e Muhamet Çamit (Kyçyku), e botuar në Bukuresht në vitin 1888 nga Jani Vreto. Vetëm se Vreto në këtë vepër ka bërë ndërhyrje të dukshme të cilat mbërrijnë deri tek tjetërsimi i koncepteve themelore të saj.¹³

Nëse do t'i hedhim një vështrim kohës kur dervish Saliu mori përsipër të kryejë kopjimin e Divanit shqip të Nezim Beratit, kuptojmë se nisma e tij nuk ka qenë e rastësishme. Pasi kohësisht përkon me ravijëzimin e lëvizjes kombëtare të shqiptarëve dhe me programin kulturor që po profilonte kjo lëvizje: lëvrimin e kulturës kombëtare dhe pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe. Vetëm dy vjet para se Dervish Saliu të fillonte punën për editimin e Divanit shqip të Nezim Beratit, më 1845 Naum Veqilharxhi shkruante "Le të hedhim farën e mire dhe me siguri vetë natyra e shenjtë e ngjarjeve do të ndihmojë për gjallërimin, mbirjen dhe rritjen e saj ...".¹⁴

Fara e hedhur në këtë lëmë nga Dervish Saliu bulëzoi me Sami Frashërin për t'u pjekur në vitet 1930, kur për herë të parë vepra e Nezim Beratit, ndonëse pjesërisht filloi të shohë dritën e botimit.¹⁵

Bibliografia:

1. Abazi-Egro, Genciana. "Sami Frashëri dhe letërsia e bejtexhinjve: një sprovë e parë për botimin e Divanit të Nezim Frakullës", *Studime Filologjike* 1-2 (2005): 119-164.
2. Berati, Nezim. *Mecmuai esar ve Divan* (dorëshkrim), Biblioteka Kombëtare Tiranë, nr. Dr. 6/ 28 D.
3. Buda, Aleks. "Ideologët e parë të lëvizjes kombëtare", *Historia e popullit shqiptar*, v. II, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
4. Burke, Peter. *The Italian Renaissance-Culture and Society in Italy*, Princeton University Press, 1986.
5. Ferhati, Abdullah. 'Divani i Nezimit nga Berati', revista *Zani i Naltë*, nr. 1-2, 3, 4, 8, 9, 10-11, 12 (1938); nr. 1, 2, 3 (1939).
6. Frashëri, Sami. *Mbledhje këngëve shqip të vjetëra dhe të ra*, Stamboll 1882. Arkivi Qendror i Shtetit, fondi i S. Frashërit, dosja nr. 1.
7. Hysa, Mahmud. "Tjetërsimi i konceptit themelor në poemën Erveheja dhe reduktimi i fabulës së poemës Jusufi dhe Zylejhaja", *Letërsia si e tillë*, f. 145-156, Tiranë: Botimet Toena, 1996.
8. İnalçık, Halil. "How to read Ashik Pashazade's history", *Essays in Ottoman History*, f. 31-54, Istanbul: Eren Yayınları, 1998.
9. Kütükoğlu, Mübahat S. *Osmanlı Belgelerinin Dili*, İstanbul: Kubbealtı Akademisi Kültür ve Sanat Vakfı, 1994.
10. nLewis, Bernard. "Ashik", *Encyclopaedia of Islam*, botimi i dytë, Brill 1999, vol. I: 697a.
11. Myderrizi, Osman. *Transkriptim i Divanit shqip të Nezim Beratit* (kopja e A. Ferhatit). Dorëshkrim, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë Tiranë.
12. Pala, Iskender. *Ansiklopedik Divan Şiiri Sözlüğü*, İstanbul: Kapı Yayınları, 2004.
13. Qosja, Rexhep. *Romantizmi I*, Tiranë: Botimet Toena 2000.
14. Üzgör, Tahir. *Türkçe Divan Dübaceleri*, Ankara: Kültür Bakanlığı, 1990.